

Fjalat e Paqes

*O Atë i Shenjtë!
Ruaj në Emër tënd
ata që ti m'i dhe
që të jenë një
sikurse ne!
(Gj 17, 11)*

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 1 (114) Viti XVI Dhjetor 2013 - Janar 2014


PAPA FRANÇESKU VËLLAZËRIMI, THEMEL DHE UDHË PËR PAQEN DITA XLVII BOTËRORE E PAQES 1 JANAR 2014

“Vëllazërimi, Udhë dhe Themel për Paqen” ishte tema e mesazhit që Shenjtëria e Tij, Papa Françesku i dërgoi botës në këtë fillim viti. Në vazhden e një tradite shumëvjeçare, Arqipeshkvia Shkodër-Pult në bashkëpunim me Komisionin Drejtësi dhe Paqe, zgjedh t’ua përcjellë këtë mesazh besimtarëve të Shkodrës në mënyrë të gëzueshme, në tempullin e kulturës në teatrin “Migjeni”, me anë të koncertit artistik “Vit të Mbarë o Shkodër!”

Para se të binte ora 18.00 e përcaktuar për hapjen e koncertit, në teatër nuk kishte asnjë vend të lirë. Plateja, amfiteatri, galeria e deri edhe lozhat, ishin tejmbushur me njerëz. Ata që ishin “zgjuar më herët” prisnin me padurim në ndenjset e tyre ndërkohë që të tjerë vazhdonin të vërshonin në sallë dhe pasi hiqnin dorë nga shpresa për të gjetur një vend për t’u ulur, strukeshin në ndonjë cep me shpinën e mbështetur pas murit.

Çuditërisht, qëndrimi në këmbë i disave, nuk ua zbehte aspak entuziazmin atyre që kishin ardhur për të dëgjuar mesazhin e Atit të Shenjtë dhe për t’iu gëzuar talentit të artistëve të rinj të Shkodrës.

Nën prezantimin dinjitoz të dyshes Marko Ripa dhe Jozefina Kolndreu, mesazhi i Papës i ndërthurur mjeshtërisht në skenar me numrat artistikë, arrinte veshët dhe zemrat e publikut që rrihte shuplakat pareshtur. Duartrokitjet që ngjallte fisnikëria e fjalëve të Papës, shkriheshin me ato që publiku u dhuronte atyre që mbushën skenën me recitime, valle e këngë duke krijuar një përzierje të rrallë emocione



midis reflektimit dhe euforisë. Kur një aktivitet i tillë del me sukses, të gjithë ata që kanë marrë pjesë qoftë si organizatorë, qoftë si artistë provojnë një ndjesi krenarie që i mban për disa orë. Është shpërblimi moral për mundin, kohën dhe emocionet e investuara. Sivjet, Arqipeshkvia Shkodër-Pult Komisioni Drejtësi dhe Paqe, gjithë artistët dhe spektatorët, patën një arsye më shumë për t’u ndjerë krenarë. Prania e Nuncit Apostolik Ramiro Moliner Ingles në koncert na nderon dhe na bën të ndjehemi të vlerësuar.

Nuk mungoi as prania e autoriteteve më të larta fetare të besimeve të tjera dhe as e përfaqësuesve të pushtetit vendor.

Në fjalën e tyre përshëndetëse, Arqipeshkvi ynë Angelo Massafra dhe Atë Nikolla Petani në emër të komunitetit ortodoks, i mëshuan më tej idesë së Papës Françesku duke shpjeguar me fjalë të thjeshta për besimtarët se si veprimet tona të përditshme dhe dashuria për njëri-tjetrin në mjediset ku jetojmë, janë zbatimi praktik i udhëzimit të Papës. Janë ajo çka Zoti,

nëpërmjet Birit të tij Jezu Krishtit ka kërkuar prej nesh.

Detyra më e vështirë e organizatorëve është zakonisht gjetja e një forme për ta përshtatur mesazhin e Papës me kontekstin shqiptar me gjithë problematikat sociale që ai mbart.

Nuk e di kujt i shkoi në mendje që aksiomën “Vëllazërimi, Udhë dhe Themel për Paqen!” ta përdorte si ndërgjegjësim të publikut për të hequr dorë nga fenomeni i shemtuar i gjakmarrjes, por padyshim

Vijon në fq. 2



PAPA FRANÇESKU VËLLAZËRIMI, THEMEL DHE UDHË PËR PAQEN

Vijim i fq. 1

që ka bërë një punë të lavdërueshme. Poezia “Vllavrasësi i Tosknisë” e Giuseppe Caparozzo, e shqipëruar nga poeti i madh Dom Ndre Mjeda, ishte një thirrje e fuqishme për vëllazërim. Loja e shkëlqyer e aktorëve Tomi Delija dhe Emiliano Palali që e shoqëruan recitimin me pantomimë, i dha tone tepër dramatike poezisë duke bërë që pika loti të rrjedhin në faqet e më shumë se një spektatorëve.

Tingujt e këngës “Happy Day”, që në shqip do të thotë “Ditë e Lumtur”, kënduar nga kori i Shkollës “Zemra e Krishtit” nën drejtimin e profesorit të muzikës Paskal Maka, ishin një surprizë tepër e këndshme në fund të shfaqjes. Them surprizë sepse askush nuk priste një nivel aq të lartë artistik nga një kor vogëlushësh dhe rezultati në fund ishte një buzëqeshje e madhe në fytyrat e gjithë spektatorëve. Një buzëqeshje që

na nxit të besojmë se në vitin 2014 do të ketë vërtetë më shumë vëllazërim e paqe.

Ja fjalimi i Arqipeshkvit Imzot Massafra:

“Vëllazërimi, themel dhe udhë për paqen”: kjo është tema e ditës XLVII Botërore për Paqen, e para e Papa Françeskut.

Dita Botërore e Paqes, e dashur prej Papa Palit VI, kremtohet ditën e parë të çdo viti. Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes u dërgohet kishave të

veçanta dhe kancelarive të mbarë botës, për të kujtuar vlerën thelbësore të paqes dhe nevojën për të vepruar pa u lodhur për ta arritur atë. Papa Françesku ka zgjedhur si temë të Mesazhit të tij të parë për Ditën Botërore të Paqes vëllazërimin. Qysh prej fillimit të shërbesës së tij si ipeshkëv i Romës, Papa ka theksuar rëndësinë për të tejkaluar një “kulturë skartimi” dhe për të nxitur “kulturën e takimit”, për të ecur drejt realizimit të një bote më të mirë dhe paqësore.

Vëllazërimi është një dhunti që çdo burrë dhe çdo grua mbart me vete si qenie njerëzore, si bir i të njëjtit Atë. Përpara dramave të shumta që godasin familjen njerëzore – varfëri, uri, nënzhvillim, konflikt, migrim, ndotje, pabarazi, padrejtësi, kriminalitet i organizuar, fundamentalizëm, vëllazërimi është themel dhe udhë për paqen.

Kultura e mirëqenies bën që të humbasë ndjenja e përgjegjësisë dhe e marrëdhënieve njerëzore. Të tjerët, në vend që të shihen si “të



ngjashëm”, shihen si antagonistë apo armiq dhe shpesh trajtohen si “leckë”. Jo rrallë të varfrit dhe nevojtarët konsiderohen “barrë”, një pengesë për zhvillimin. Ata kthehen në objekte ndihme asistencialistike apo mëshirimi. Domethënë nuk shihen si vëllezër, të thirrur për të bashkëndarë dhuratat e krijimit, të mirat e përparimit dhe të kulturës, për të marrë pjesë në të njëjtën tryezë të jetës në plotësi, për të qenë



protagonistë të zhvillimit tërësor dhe përfshirës.

Vëllazërimi, dhuratë dhe angazhim që vjen prej Hyjit Atë, na nxit që të angazhohemi për të qenë solidarë kundër pabarazisë dhe varfërisë, që dobësojnë jetesën shoqërore, për t'u kujdesur për çdo person, sidomos për më të vegjlit dhe më të pambrojturit, për ta dashur atë si vetveten, me vetë zemrën e Jezu Krishtit.

Në një botë ku rritet pareshtur varësia nga njëri-tjetri, nuk mund të mungojë e mira e vëllazërimit, që fiton mbi përhapjen e atij globalizimi të shpërfilljes, për të cilin shumë herë ka folur Papa Françesku. Globalizimi i shpërfilljes duhet t'ia lërë vendin globalizimit të vëllazërimit. Vëllazërimi u bëftë pjesë e çdo aspekti të jetës, përfshi ekonominë, financën, shoqërinë civile, politikën, kërkimin, zhvillimin, institucionet publike dhe kulturore.

Papa Françesku, në fillim të mbarështimit të tij, me një Mesazh që është në vazhdimësi me mesazhet e Paraardhësve të vet, u propozon të gjithëve udhën e vëllazërimit, për t'i dhënë botës një fytyrë më njerëzore.

Vladimir Banushi



FESTA E FAMILJES NË SHENJTËROREN E ZOJËS



FAMILJET MBLIDHEN NË LUTJE

Në shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë me dt. 28 dhjetor 2013 në orën 9.30, me nismën e komisionit dioqezan për familjen në praninë e Arqipeshkvit tonë dhe të shumë meshtarëve dhe motrave që shoqërojnë vazhdimisht jetën e familjeve tona, në kuadër të vigjiljes së Festës së Familjes së Shenjtë ishin mbledhur familjet në lutje nga shumë famulli të dioqezës sonë. U zhvillua Liturgjia e Fjalës si dhe pjesë nga fjala e Papa Françeskut për familjen nën shembullin e Familjes Shenjtë të Nazaretit, që çdo familje të ketë praninë e Zotit në mesin e tyre.

Atmosfera ishte me të vërtetë familjare, ku në kishën e mbushur plot u dëgjuan leximet liturgjike si dhe fjala e Arqipeshkvit të dioqezës Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra. Ky aktivitet u pasurua me poezi kushtuar familjes të interpretuar nga Zita Ujka, Zef Ndoja e Paulin Ujka si dhe këngë të ndryshme fetare të nxitura nga famullitari i famullisë së Shën Shtjefnit don Gjovalin Sukaj poashtu edhe këngë nga musicol “Ejani njerëz” i drejtuar nga Zef Ndoja.

Ashtu si në familje u përfshinë me gëzim në këngë edhe një grup i improvizuar që përbëhej nga Imzot Massafra me harmonikë, dom Raffaeli me kitarë dhe Dom Abram me flaut të cilët kënduan një version të vjetër të këngës “Ti ulesh prej Parrizi”.

Të gjithë bashkëshortët e pranishëm dolën përpara të kapur dorë për dorë dhe Arqipeshkvi i lexoi ritin e martesës si shenjë të ripërtëritjes e përforcimit të lidhjes martesore. Unë nuk e kisha bashkëshorten të pranishme për arsye shëndetësore, por kur u kthyem në shtëpi vajza ime me fletën e lutjes që morëm në këtë takim na lexoi ritin e martesës duke na përforcuar me fjalët e arqipeshkvit.

Takimi familjar i lutjes përfundoi me bekimin e Arqipeshkvit dhe me një drekë në oborrin e shëjtërores që ishte organizuar nga bujaria e famullisë të Gurit të Zi.

Paulin Ujka

KËSHILLË PËR PRINDËRIT
(Ambrozi Ipeshkëv i Milanos shek. IV)

Edukimi i fëmijëve është një punë për të rritur, të gatshëm për një përkushtim që harron vetveten: për këtë detyrë janë të aftë ata bashkëshortë të cilët duhen mes tyre, që dashurinë e nevojshme nuk e kërkojnë diku tjetër. E mira e fëmijëve tuaj do të jetë ajo që ata vetë do ta zgjedhin: mos ëndërroni për ta dëshirat tuaja. Mjafton që ta duan të mirën, të largohen nga e keqja dhe ta kenë tmerrë gënjeshtren.

Mos pretendoni pra të parashikoni të ardhmen e tyre: të jeni krenar që ata shkojnë drejtë së ardhmes me vull, edhe nëse ju duket se për një moment po ju harrojnë. Mos i inkurajoni fantazi

madhështie, nëse Zoti i thëret për diçka të bukur dhe të madhe, të mos jeni ju ata që t’ia pengoni fluturimin. Mos ia lejoni vetes që të vendosni ju në vend të tyre, por ndihmoni që të kuptojnë dhe të vendosin, dhe të mos kenë frikë, se ajo që duan kërkon mund dhe ndonjëherë i bën të vuajnë: është më e padurushme një jetë që jetohej kot.

Më shumë se këshillat tuaja do t’i ndihmojë vlerësimi që kanë për ju dhe që ju keni për ta; më shumë se njëmijë rekomandime të lodhshme ata ndihmohen nga disa gjeste që shohin në shtëpi: dashuria e thjeshtë, vlerësimi i ndërsjelltë, dominimi i pasioneve, shija ndaj gjërave të bukura dhe forca për të buzëqeshur. Ndër të gjitha diskutimet mbi dashurinë asnjëri nuk do të më mësonte më shumë se sa sjellja e nënës sime që strehon një endacak të uritur, dhe nuk gjej gjest më të bukur për të qënë krenar si njeri, se sa kur babai im doli përpara për të marrë në mbrojtje një burrë që ishte akuzuar padrejtësisht.

Fëmijët tuaj duhet të jetojnë në shtëpitë tuaja me ndjenjën që të bën të ndihesh mirë, që të jep forcë që të dalësh nga shtëpia, sepse brenda vetes janë këto që të rrisin besimin në Zotin dhe shijen e të jetuarit mirë.

Perkthej Meri Ujka

LUTJA E PRINDIT

O Zot, t’i besoj ty fëmijët e mi; vëzhgo mbi ta.
I kam rritur nën hirin tënd, me dashurinë tënde.
Pak e nga pak po shkëputen nga unë. Janë persona.

O Zot, unë nuk po të lutem që t’i largosh prej tyre vështirësitë,
por bëj që ato të gjejnë në Ty forcën për t’i përballuar,
dhe vështirësitë do t’i bëjnë njerëz.

Unë nuk të lutem që t’i shmangësh atyre zhgënjimet e jetës,
por të ruash në ta shpresën e besimin.
Me këtë përvojë mund ta bëjnë botën më të mirë.

Kam kërkuar me punë të kujdesshme të mësohen të bëjnë edhe pa mua, pa mua, por jo pa Ty o Zot.
Ti m’i dhurove e m’i besove, tashti jam unë që t’i besoj Ty,
Ty, që mund t’i ndjekësh ngado; më mirë se sa munda të bëj unë.

E në qoftë se nuk do t’i mungojë, o Zot, pjesa e tyre e dhimbjes së përditshme, jepi atyre, të lutem, forcën për të bashkuar dhimbjet e tyre me atë të Birit Tënd hyjnor. O Zot, po të lutem, vëzhgo mbi fëmijët e mi.



JAVA E LUTJES PËR BASHKIMIN E TË KRISHTERËVE

“Vallë, a qenka Krishti i ndarë” (1 Kor 1,13)



pranishmit. Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra e Atë Nikollë Petani, drejtuan dy momentet e lutjes, duke rikujtuar në predikim temën e këtij viti: “Krishtin nuk mund të ndahet” (1Kor1,1-17).

Sikurse bashkësisë së Korintit që po tejkalonte momente të vështira në mes të grupeve të ndryshme që i drejtoheshin njërit apo apostullit tjetër, Pali kujton që ka qenë Krishti i cili dha jetën për shëlbimin e botës, kështu dy përfaqësuesit e Kishës Katolike dhe asaj Ortodokse, na kanë ftuar ta vendosim në qendër fenë në Krishtin, Zot dhe Shëlbues; t’i kushtojmë rëndësi asaj që na bashkon e jo asaj që na ndan, t’i gjejmë rrënjët e përbashkëta në Atë që vdiq dhe u ngjall për ne.

Vetëm atëherë lutja jonë do të bashkohet me atë të Jezusit që gjithmonë ia drejton Atit: «që të gjithë të jenë një. Sikurse ti, Atë, që je në mua dhe unë në ty, ashtu edhe ata të jenë në ne, që ta kuptojë bota se ti më dërgove» (Gj 17,21).

Në pritje të javës ekumenike të vitit tjetër, të vazhdojmë të lutemi dhe të zgjojmë momente të bashkimit dhe të vlerësimit të ndërsjellët.

Dom Leonardo Falco

Që nga viti 1968 prej 18 deri më 25 janar të çdo viti kremtohet në mbarë botën, Java e lutjes për bashkimin e të krishterëve. Një rast për t’i ngritur duart kah qielli, të kërkojmë falje për mëkatet e ndarjes dhe të kërkojmë nga Zoti dhuratën e bashkimit për të gjithë bijtë e tij.

Edhe këtë vit në Shkodër janë mbajtur dy takime lutjeje: një në katedrale e tjetri në kishën ortodokse. Shumë prekëse lutja e mbrëmësore tek Katedralja të hënën me 20 janar, në praninë e shtatores së Zojës Shtegtare të Fatimas. Sikurse pas Pashkëve apostujt ishin të bashkuar me Marinë në pritje të Shpirtit, kështu edhe njëherë katolikë e ortodoksë u gjetën së bashku rreth saj për të kërkuar dhuratën e bashkimit të kishave. Pjesëmarrja e besimtarëve ishte e madhe edhe pse ndërkohë shiu rrihte papushim qytetin.

Të enjten me 23, u takuam te kisha ortodokse, për t’u lutur jo vetëm me shoqërimin e Marisë, por edhe me një numër të shumtë të Shenjtërve dhe Engjëjve, që nga ikonostazia e mrekullueshme dukeshin se ishin bashkuar në lutje me të



MARSHIMI I PAQES



Të shtunën, më 4 janar 2014, u zhvillua në Shkodër marshimi “Paqe në të gjitha tokat”, i nxitur nga Bashkësia e Shën Egjdit në bashkëpunim me Arqidiozeqën e Shkodër-Pultit.

Më se 500 vetë morën pjesë në korteun e gëzueshëm të drejtuar nga Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra dhe nga Atë Nikolla Petani, përfaqësues i Kishës Ortodokse në Shkodër.

Bashkësia ftoi që të reflektohej mbi mesazhin e Papa Françeskut me rastin e Ditës Botërore të Paqes, duke theksuar rëndësinë e dialogut, të faljes dhe të pajtimit. Qe një rast për të kujtuar si luftërat në botë, si problemin e gjakmarrjes sipas kodit të hershëm zakonor shqiptar të kanunit, që edhe sot detyron shumë familje të jetojnë të mbyllura prej frikës se pësojnë dhunë.

Veçanërisht domethënëse qe dëshmia e z. Sokol Hilit, që i përket një familjeje të përfshirë në gjakmarrje por që ka zgjedhur rrugën e pajtimit. Kujtoi se “heshtja mund të duket zgjedhja më e mirë, por falja është rruga për

Vijon në fq. 12

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR



Imzot Angelo Massafra Arqipeshkvi ynë, është angazhuar që të vinte në Shqipëri Zoja shtegtare e Fatimas, për të na ndihmuar që të vazhdojmë Ungjillëzimin e popullit tonë me një zell më të madh. Statuja e Zojës arriti në aeroportin Nëna Tereza në Tiranë duke nisur nga Fatima via Istambullit dhe pas shtegtimt në dioqezat e Shqipërisë do të kthehet në Fatima në fund të muaj marsit 2014.

Nga Sekretaria e Zyrrave të Fatimas kanë bërë një intervistë mbi vlerën e shtegtimt të Zojës së Fatimas. Në vijimë janë pyetjet e Sekretarisë dhe përgjigjet e Imzot Angelo Massafres, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult dhe President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, që bëri më 19 janar 2014.



Pse nisma e realizimit të këtij shtegtimi?

Është e nevojshme që popullit të Zotit t'i jepet mundësia e përvojave të forta, nxitëse, që e ndihmojnë ta jetojë më mirë shtegtimin e fesë.

Sapo kemi përfunduar Vitin e Fesë dhe, duke menduar për Marinë që ka qenë shtegtare e fesë në mënyrë të veçantë, kemi



menduar se askush më mirë se Ajo nuk mund të na ndihmojë ta bëjmë këtë shtegtim me mbrojtjen e saj amënore dhe me udhëheqjen e saj.

Gjithashtu Maria është Mbretëresha e paqes. Duam ta vëmë nën mbrojtjen e saj gjithë botën dhe veçanërisht Shqipërinë, një tokë dhe një popull që ka vuajtur shumë, dhe që vazhdon të vuajë jo më prej komunizmit, por prej “gjakmarrjeve” të cilat i detyrojnë shumë familje të mbeten të burgosura në

Vijon në fq. 6

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

Vijim i fq. 5

shtëpitë e tyre. Duam t'ia besojmë Marisë të gjithë personat më të dobët, në veçanti fëmijët, vejushat, të sëmurët, të varfrit dhe emigrantët në gjithë botën dhe sidomos shenjtërimin e pajtimin e të gjitha familjeve.

Së fundi, kjo nismë kurorëzon ëndrrën që kisha në zemër prej shumë vitesh, pasi që në vitin 1998 kemi rikushtuar Shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë në Shkodër; në ditët 19-26 shtator 1998 kemi pritur në Shkodër Statujën e Zojës së Nazaretit dhe pastaj shtegtimin e Ikonës së Nënës së Këshillit të Mirë, Pajtores e Shkodrës dhe e Shqipërisë në 1999-2000 në të gjitha famullitë e Dioqezës së



Shkodrës e të Sapës në përgatitje për Vitin Jubilar 2000.

Cilat janë pritjet tua baritore në lidhje me praninë e Statujës së Virgjërës së Fatimas në Shqipëri?

Para së gjithash t'ia besojmë Marisë krejt popullin shqiptar;

Në rend të dytë, presim që Mesazhi i Fatimas, prej përmbajtjeve të tij të forta, të përforcojë ecjen e fesë të të krishterëve të Shqipërisë, të thelluar tashmë gjatë Vitit të Fesë, në mënyrë që të rritemi gjithnjë e më shumë në dëshmi dhe në misionaritet.

Si fryt presim që ftesa e Marisë për kthim të na hapë ndaj një të ardhmeje paqeje, nëpërmjet dialogut, respektit të ndërsjellë, mirëkuptimit; më në fund të kuptohet se është më bukur të dhurojmë e të falim se sa të hakmerremi.

Të jepet mundësia që të njihet më mirë historia dhe mesazhi i Fatimas, shumë aktual edhe sot këtu në Shqipëri.



Nga programi i parashikuar (e di se do të rrijë në Shqipëri nga gjysma e janarit deri në mars 2014), a mund të na vini në dukje një apo dy momente që sipas Jush do të jenë më domethënëse?

Sigurisht se do të ketë disa momente domethënëse në të gjitha Dioqezat në të cilat do të ndalet Statuja e Virgjërës Shtegtare. Po kufizohem të përmend ato të parapara për dioqezën e Shkodër-Pultit dhe nismat e ditës së parë të mirëpritjes:

Vijon në fq. 7

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

Vijim i fq. 6

Arritja e Zojës së Fatimas në Shenjtëroren e Zojës së Këshillit të Mirë në Shkodër, (më 18 janar 2014 në orën 9.45) ka qenë një moment shumë i bukur, i gëzueshëm, emocionues dhe domethënës, që ka parë një grumbullim të madh të besimtarëve, të udhëhequr prej meshtarëve të tyre, që kanë kremtuar Meshën e shenjtë në Shenjtërore në orën 8.30, dhe në pritje të arritjes së Virgjërës Shtegtare kanë rrëfyer. Pas mirëpritjes zyrtare të Arqipeshkvit dhe të Famullitarit, meshtarët, me radhë, kanë udhëhequr recitimin e Rruzares së Shenjtë: të gjithë meshtarët dhe besimtarët i kishim sytë të drejtuar dhe të ngulitur në Virgjërën e Bardhë Shtegtare. Në Shenjtërore u bë ndalesa e parë për të vazhduar pastaj drejt Katedrales ku u prit me entuziazëm të madh prej fëmijëve dhe adoleshentëve të katekizmit. Këta, së



e vëllazërisë me një darkë të përbashkët në sallonin e famullisë.

Qe programuar dhe u realizua Adhurimi Eukaristik i përhershëm dhe gjatë natës (e diel 19 – e hënë 20, nga ora 17.00 deri në orën 7.00 të mëngjesit) me alternimin e rregulltarëve, rregulltareve, grupeve rinore. Kjo qe një përvojë shumë e fortë feje dhe pranie të shumë besimtarëve në adhurimin e Jezusit të paraqitur në mënyrë kremtoare mbi altar në shoqërinë e Virgjërës Shtegtare!

Një moment i fortë është me siguri Treditëshja që do të mbahet në Katedralen e Shkodrës (27,28 e 29 janar) kushtuar Adhurimit të të Shenjtërueshmit Sakrament, Predikimit dhe



bashku me besimtarë të tjerë të ardhur nga anë të ndryshme të Dioqezës, e kanë mbushur Kishën Katedrale plot e përplot, përtej çdo pritjeje!

Mbrëmjen e së shtunës (18 janar) në orën 18, Famullitari i Katedrales, Don Gjovalin Suka, i ftoi të gjitha Motrat e Kongregatave të ndryshme të pranishme në Shkodër për kremtimin e Mbrëmësorës, të udhëhequr nga Arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra, përreth altarit dhe Virgjërës Shtegtare: jetuam një moment të bukur feje e vëllazërie duke e falënderuar atë që ka ardhur në Shqipëri dhe duke kërkuar dhuratën e një angazhimi më të madh në ungjillëzim. Pastaj e vazhduam momentin



Rrëfimeve sakramentale; treditëshja do të kulmojë me procesionin e Virgjërës Shtegtare nëpër disa rrugë të qytetit të Shkodrës.

Kushtimi i Dioqezës Virgjërës gjatë Meshëve të Shenjta të të dielave dhe sidomos ditën e fundit, më 7 shkurt.

Procesioni “aux flambeaux” ditën 6 shkurt kur do të hershojmë Ditën Botërore të të sëmurit, në vend të ditës 11, përkujtimi liturgjik i Zojës së Lurdit.

Shtegtimet nga famullitë dhe nga zonat baritore në Kishën Katedrale, ku qëndron statuja e Virgjërës Mari Shtegtare e Fatimës. Në katedrale parashihet shërbimi i rrëfimeve.

Vijon në fq. 8

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

Vijim i fq. 7



Si mund ta përshkruajmë, shkurtimisht, popullin shqiptar në lidhje me devotshmërinë ndaj Marisë?

Devotshmëria ndaj Zojës së Bekuar ka qenë gjithmonë shumë e fortë dhe shumë e ndier prej njerëzve në Shqipëri. Mjafton të kujtojmë se gjatë komunizmit, pas shkatërrimit të Shenjtërores së kushtuar Zojës së Këshillit të Mirë, pajtores e Shqipërisë dhe sidomos e Shkodrës, njerëzit shkonin gjithsesi për t'u lutur atje, ku dikur gjendej Shenjtëroja. Në të vërtetë, kjo është e vetmja Shenjtërore e kushtuar Nënës së Hyjit në Shqipëri. Gjatë muajit maj dhe gjatë festave të tjera, janë me qindra personat që marrin pjesë në Meshën e Shenjtë që, prej pjesëmarrjes së shumtë të popullit, kremtohet përjashta.

Jo vetëm kaq, por në periudhën e regjimit komunist në Shqipëri, kur ishte i ndaluar çdo gjest i jashtëm lutjeje ashtu siç ishte e dënueshme edhe të bëhej shenja e kryqit, në shumë familje thuhej Rruzarja e shenjtë, ndërsa njëri prej familjareve rrinte jashtë, si roje e shtëpisë, për të mos lejuar që dikush të vinte e të shikonte se çfarë bëhej! Mund të pohoj me siguri absolute se lutja drejtuar Virgjërës, me Rruzaren e shenjtë, e ka mbajtur gjallë fenë e krishterë të shqiptarëve gjatë përndjekjes.

A ekziston në Shqipëri devotshmëria ndaj Virgjërës



së Lume të Fatimas? A njihen historia dhe Mesazhi i Fatimas? A ka ndonjë shenjtërore, bazilikë apo kishë, të kushtuar Zojës së Fatimas?

Historia dhe mesazhi i Fatimas me siguri njiheshin para

komunizmit: duke rishikuar disa numra të “Kumbona e së Dielës” së vitit 1943 (revistë e dioqezës së Shkodrës, e mbyllur nga regjimi komunist dhe që e kemi rihapur në vitin 1992) kemi gjetur lutjen e kushtimit të Papa Piut XII, (përkthyer në shqip) si dhe kushtimet e ndryshme Zemrës së Papërlyer të Marisë të Dioqezave të Shkodrës, të Durrësit dhe të disa famullive.

Gjithashtu, njëhej dhe praktikohesh devotshmëria e 5 të shtunave në nder të Zemrës së Papërlyer të Marisë, komentuar dhe paraqitur mirë nga libërthi në gjuhën shqipe: “Pesë të shtunat në nder të Zemrës së Papërlyer të Zojës”.

Për sa u përket kishave: në dioqezën e Shkodër-Pultit, dhe saktësisht në Oblikë, kemi një Qendër Baritore të kushtuar të Lumëve Françesk e Jacinta dhe Kisha është e kushtuar Zojës së Fatimas. Por është interesante që në Gramzë (Durrës), kisha e parë, e rindërtuar pas rënies së komunizmit, i është kushtuar Zemrës së Papërlyer të Zojës, dhe mban në ballë të saj fjalët e Zojës së Fatimas:

“Zemra ime e Papërlyer do të ngadhënjë”.



DITA BOTËRORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ekspozita “Ne jemi të aftë”

Në sallën “Kardinal Mikel Koliqi” pranë Arqipeshkivës Shkoder-Pult, ora 17.00, me një kënaqësi të madhe Projekti Shpresa kremtoi Ditën Botërore të të Drejtave të Njeriut.

Kjo ditë është shpallur në vitin 1948 por pranimi formal si Dita e të Drejtave të Njeriut është bërë nga Asambleja e Përgjithshme e Shteteve të Bashkuara në vitin 1948, për t’u tërhequr vëmendjen 'njerëzve të botës' për Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut si standardi i përbashkët i arritjes për të gjithë njerëzit dhe të gjitha kombet. Po a është kështu edhe për Shqipërinë, edhe për qytetarët e saj, ndër këta a është edhe për Projektin Shpresa?

Projekti Shpresa për 17 vite me radhë vazhdon të propozojë që tu sigurojë të rinjve e të rejave me aftësi të kufizuar jo vetëm hapësira të rritjes psikologjike por edhe të marrëdhënieve në të cilat të jetojmë jetën tonë të përditshme, por edhe një përgjigje të plotë ndaj nevojave tona, sidomos duke përfshirë futjen e tyre në Shoqërinë Civile për ushtrimin e plotë të të drejtave tona të qytetarisë.


Prandaj, si thirrje dhe kërkesë në Ditën Botërore të të Drejtave të



Njeriut, Projekti Shpresa organizoi Ekspozitën “Ne jemi të aftë” me punimet e fëmijëve/ të rinjve/ të rejave për të nxitur vetëdijen e çështjeve të të drejtave të njeriut dhe që nënvizon një përpjekje për të përmirësuar të drejtën tonë njerëzore, si dhe talentin e tyre.

Një program hyrës dhe prezantua nga i riu i Shtëpi-Familje Gabbiano të Projektit Shpresa, Klodjan Kodra i cili në vijim të programit për kënaqësinë e të pranishmëve dhe të të rinjve e të rejave me aftësi të kufizuar të Projektit Shpresa në veçanti, ftoi Shkelqësinë e tij, Imzot Angelo Massafra, i cili na nderoi me prezencën e tij në ditën Festive. E ftuan me një duartrokitje dhe të gjithë dëgjuam me vëmendje përshëndetjen e tij.

Në kumtesën e shkurtër dhe domethënëse, që ka mbajtur, përgëzoi punën e të rinjve e të rejave që bëjnë gjatë kohës që angazhohen në Qendrën Ditore, ata arrijnë të bëjnë gjëra kaq të bukura, domethënëse nëpërmjet të cilave të arrijnë që të japin edhe një mesazh për të shprehur të drejtën dhe talentin e tyre. Ndër të tjera Imzot. Masafra theksoi se kjo punë bamirësie, e thellë njerëzore është bërë në sajë të një pune të palodhur e të përkushtuar të ish të ndjerës Presidentes Silvana Vignali dhe solidaritetit ndërkombëtar Italian dhe Spanjoll por ata të cilët duhet t’i përkushtohen kësaj



çështjeje është pikërisht shteti sepse 60 të rinjtë e të rejat e Projektit Shpresa janë bijtë e shtetit shqiptar.

Pas mesazhit dhe thirrjes që lëshoi Imzot Angelo Massafra ndaj instancave më të larta shtetërore, u ftua Presidenti i Projektit Shpresa, Z. Luigj Mila, i cili përcolli mesazhin se sado që bëjmë për këta të rinj e të reja është e pakët në krahasim me të drejtën e tyre legjitime për të cilën duhet të investohet dhe të bëhet një kontribim i madh njerëzor dhe financiar. Ai ndër të tjera falenderoi shumë edhe Dom Gjovalin Sukaj për mbështetjen e dhënë në realizimin e kësaj ekspozite

Fjalët që përcollën Imzot Massafra dhe Presidenti Mila janë të rëndësishme dhe nevojiten të vlerësohen shumë, sepse lëshojnë një thirrje të madhe për të drejtën e personave me aftësi të kufizuar si çdo njeri tjetër normal. Duke i falenderuar, Ekspozita u quajt e hapur duke ftuar secilin prej të pranishmëve, të cilët ishin të shumtë, ku përveç të rinjve e të rejave, stafit oragnziativ dhe edukatorët e projektit Shpresa, edhe përfaqësues, të rinj e të reja me aftësi të kufizuar nga Instituti i Motrave të Nënë Terezës, Madonnina del Grappa, Qendra e Zhvillimit Shtetëror, Motrat Stigmatine, studentë nga Universiteti Luigj Gurakuqi, e mjaft dashamirës të tjerë që të sodisin dhe të vlerësojnë nga afër të gjitha punimet e realizuara nga fëmijët/të rinjtë dhe të rejat e Projektit Shpresa. Gjithashtu ftuan zëra bashkëpunues që të bëjnë një kërkesë apo thirrje në kuadër të kësaj Dite e cila duhet respektuar jo me fjalë por vetëm me vepra. Në vijim po paraqes të plotë fjalimin e Arqipeshkvit:

“Jam me të vërtetë i lumtur të jem këtu me ju sonte në përrurimin e kësaj Ekspozite: një ngjarje që na është dhënë për të vlerësuar angazhimin e djemve e vajzave që i kanë prodhuar këto punime. Por, sipas mendimit tim, ajo që po bëjmë sonte është shumë më tepër. Në të vërtetë, ndërsa do të sillemi mes punimeve të ekspozuara, nuk do të kufizohemi vetëm duke admiruar punën, por do të jemi të ftuar të reflektojmë mbi faktin se ajo që jemi duke admiruar është vetëm pikarritja e një itinerari të gjatë brenda të cilit janë drejtuar historitë e këtyre të rinjve, të familjeve të tyre dhe të atyre që janë vënë pranë tyre për t’i ndihmuar që të vlerësohen aftësitë e tyre dhe krijimtaria e tyre.

Pra, po flasim për persona, për qenie njerëzore, me një dinjitet të tyre. Jo rastësisht, kjo Ekspozitë përurohet ditën në

Vijon në fq. 10

DITA BOTËRORE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Ekspozita “Ne jemi të aftë”

Vijim i fq. 9

të cilën e gjithë bota kremton Ditën e 65-të ndërkombëtare të të drejtave njerëzore. Në këtë ditë e gjithë bota kthehet të reflektojë mbi motivimin themelor për të cilin kjo Ditë është themeluar: pra, ekzistojnë të drejta të cilat çdo qenie njerëzore duhet të ketë mundësinë t'i gëzojë për arsyen e vetme se është në botë.

Që nga 10 dhjetori 1948 deri sot janë bërë shumë hapa në këtë drejtim dhe i gjithë njerëzimi është bërë shumë më i ndjeshëm, falë edhe personave që për mbrojtjen e të drejtave njerëzore kanë vuajtur shumë. Sot – çfarë koinçidence! – është varrimi i atij njeriu të madh, Nelson Mandelës, që gjithë bota e qan dhe e falënderon. Por vetë fakti se është nevoja të kremtohet kjo, sikurse shumë Ditë të tjera botërore brenda dhe jashtë Kishës, na tregon se ecja është ende e gjatë dhe se një ndjeshmëri e tillë duhet të nxitet gjithmonë, në individët ashtu si edhe në Institucionet. Nga ana tjetër, Kisha katolike nuk ka reshtur kurrë së nxituri respektimin e jetës dhe të personave, dhe gëzohet kur sheh se edhe pranë besimeve të tjera apo në botën laike punohet në mënyrë që të drejtat themelore të personit të respektohen.



Prandaj, ndërsa gëzohem së bashku me ju për çka është realizuar së bashku nga këto djem e vajza (dhe për këtë falënderoj me gjithë zemër të gjithë ata që kanë ndihmuar në këtë realizim), përfitoj prej rastit edhe për të nxitur të gjithë ata që kanë përgjegjësi institucionale në qytetin tonë dhe në gjithë Kombin për të shpenzuar energjitë më të mira që kanë në mënyrë që personi njerëzor dhe, në mënyrë të veçantë, më të dobëtit dhe ata që nuk kanë zë, të respektohen e të favorizohen në të drejtat e tyre themelore.

Të gjithë të pagëzuarve, pastaj, u kujtoj se mësimi më i madh që Jezusi na ka lënë është ai i dashurisë vëllazërore, të bazuar në dashurinë që

Ai ka pasur dhe ka për secilin prej nesh. Duke nisur prej kësaj karakteristike të pashmangshme të fesë sonë, mundemi me të vërtetë të bashkëpunojmë në ndërtimin e një bote më të drejtë e vëllazërore ku çdo person, pavarësisht prej racës së tij, prej kulturës së tij apo prej fesë së tij, të vlerësohet në përmasën e vet më të madhe, atë të të qenit bir i Hyjit.

*Suela NDOJA, MSc
Psikologe Klinike*

NËNTËDITËSHJA E KRISHTLINDJES NË FERMENTIM



Me rastin e vitit të fesë, çdo famulli e Dioqezes sonë është thirrur të aktivizohet për të thelluar dhe për t'u ndërgjegjësuar ne misteret e fesë sonë. Ne motrat Baritore në qendrën Jezusi Bariu i Mirë në Fermentim, kemi dashur të angazhojmë të gjithë bashkësinë, në menyrë të veçantë të rinjtë, mbi misterin e Mishërimit. Si t'i ndihmojmë të rinjtë për ta jetuar sa mirë pritjen e Jezusit, që ka ardhur, që vjen dhe që do të vijë?

Në çfarë menyrë t'i afrojmë të rinjtë pranë këtij misteri të madh të dashurisë që na rrethon dhe na mrekullon? Të ndihmuar nga Shkrimi



i Shenjtë dhe tradita liturgjike e Kishës kemi ndjekur etapat e Engjellit Gabriel, duke dëgjuar Ungjillin dhe duke e vënë në skenë të shoqëruar me melodi klasike, që lusin ardhjen e Jezusit, kemi përjetuar me fëmijët dhe të rinjtë këtë kohë të fortë të nëntëditëshes.

Pjesëmarrja ka qenë shumë domethënëse, në mbyllje të nëntëditëshes na ka gëzuar prania e Ipeshkëvit tonë Imzot Angelo, i cili na ka bekuar. Fëmijët kanë shprehur gëzimin e tyre dhe falënderimin me këngat, vjershat dhe me një dramë.

Moter Maddalena

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

SHUGURIMI DIAKONAL I EMILJAN PALOKËS

Në ditën e Shën Gjorit të kryqit, Emiljan Paloka, një person i thirrur prej Zotit nëpërmjet Kishës së tij, pas studimeve hap pas hapi siç e parasheh rregulli i studimeve për të arritur në Meshtari, mori Urdhërin e Shenjtë të Diakonatit.

Me falenderimin ndaj Zotit për këtë dhuratë që i bëri Dioqezës së Sapës, kishës dhe popullit të saj, ceremonia e shugurimit u mbajt me 14.12.2013 në Katedralen Nënë Tereza në Vau-Dejës në prani të bashkësisë dioqezane, meshtarëve e motrave, familjarëve dhe miqve të Emiljanit. Mesha e shenjtë u kryesua nga Ipeshkëvi i vendit Imzot Lucjan Avgustini në bashkëkremtim me rreth 50 meshtarë të tjerë. Pas shpalljes së Ungjillit, ish Vikari i përgjithshëm i Sapës, Dom Karlo Fantini, i cili po ndjek nga afër studimet përfundimtare të tij në Itali, dhe sipas informatave, dëshmoi se akoliti Emiljan Paloka është i gatshëm për të marrë urdhërin e meshtarisë në cilësinë e diakonit.

Ndërsa gjatë fjalës së rastit Shkëlqesia e Tij, Imzot Lucjan Avgustini, u ndal në rëndësinë e të qenurit diakon, ku dashuria ndaj Zotit dhe njëri-tjetrit realizohet nëpërmjet shërbimit të përvujtë, sikurse na mëson vetë Krishti. Pikërisht këtu e gjen kuptimin Diakoni. Duke iu drejtuar kandidatit me emër, ai i tha se ti me shugurimin diakonal bëhesh shenjë e gjallë e Krishtit shërbëtor. Ndaj duhet të angazhohemi për të



marrë ato ndjenja të dashurisë së Krishtit. Ne bashkë me ty i lutemi Zotit që të të bëhet ndihmë në shërbim të tij. Gjithashtu Ipeshkvi, nuk harroi të kujtonte edukatorët e Emiljanit, si i ndjeri Dom Injac Dema që e pagëzoi, i ndjeri Dom Genc Tuku, dhe meshtarë të tjerë që e ndihmuan në ecjen dhe formimin e tij në vite. Po ashtu, ai falenderoi dhe përgëzoi edhe familjen e tij që e mbështetën birin e tyre duke ia hapur zemrën Zotit, duke pranuar thirrjen dhe kushtimin e djalit të tyre si vullnet të Zotit, dhe duke i dhënë bekimin fëmijës së tyre. Me urimin: Krishti Bariu i mirë qoftë udhëheqësi yt në ecjen tënde drejt meshtarisë, përfundoi dhe homelia e rastit.

Me të mbaruar homelia, ipeshkvi kërkoi prej kandidatit gatishmërinë për të ushtruar shërbesën e diakonatit dhe për të jetuar një jetë në bindje dhe celibat, sipas dëshirës së Krishtit dhe Kishës së Tij. Vetë kandidati me pëlqimin e tij, iu përgjigj Zotit duke thënë “Ja ku jam o Zot!”

Më pas vazhduan ritet e pranimit të Urdhërit Diakonal, duke bërë që Emiljani të ushtrojë shërbesën e diakonatit me përvujtëri dhe dashuri në ndihmë të Urdhërit Meshtarak dhe në shërbim të popullit të krishterë. Me shenjat e shërbesës së tij, të cilat ishin petkat, stola që është gjithnjë shenjë e Urdhërit të Shenjtë dhe dalmatiku, tani e tutje Emiljani u pranua në kolegjin diakonal dhe do të vazhdojë me shërbimin në elter deri në Shugurimin Meshtarak, duke u bashkuar kështu me familjen e madhe të Zotit, për t'i shërbyer Zotit dhe Kishës.

Violeta Marashi

LEZHA PËRKUJTON 546 VJETORIN E VDEKJES SË GJERGJ KASTRIOTIT

Ditën e premte, me dt. 17 janar 2014 u zhvillua një Ceremoni Përkujtimore me rastin e 546 vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti “Skenderbeu”.

Ky qe programi: në orë 10.00 pritja e të ftuarve tek Bashkia e Lezhës, pas vizita në Vendvarrimin (Memorialin) e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti. Përsëritet, fillimisht Kryetari i Bashkisë Z. Viktor Tusha, me këto fjalë: “Të nderuar pjesëmarrës. Në këtë vend prehen eshtrat e Gjergj Kastriotit, Skenderbeut, i cili i është imponuar historisë së Shqipërisë si figur e heroit kombetar, Europës si kalorës i krishtërimin e simbol i qëndresës, mesjetës si një ndër gjeneralet e politikanët më të shquar, popullit shqiptar si simbol i identitetit dhe flamur i luftërave shekullore për liri e

prosperitet....

Pikërisht ky njeri, do të shfaqej në historinë shqiptare si figur e dorës së parë dhe u ngrit në historinë e Europës si perfaqësues i Arbërisë mesjetare dhe asaj moderne...

Historia e Skenderbeut është një histori politike, dhe histori ushtarake. Historia e jetës, luftërave, fitorëve, lavdisë dhe vdekjes e tij, është një histori madhështore, histori për t'u njohur e kujtuar, treguar e studjuar, kujtuar e nderuar, një histori njerzore, histori për t'u shenuar dhe për t'u krenuar, një histori epike e papërsëritshme...”

Më pas morën fjalën Imzot Angelo Massafrà OFM, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult dhe Presidenti i Konferencës Ipeshkvnore të

Vijon në fq. 12

LEZHA PËRKUJTON 546 VJETORIN E VDEKJES SË GJERGJ KASTRIOTIT



Vijim i fq. 11

Shqipërisë, i cili duke kujtuar se Heroi ynë bashkoi të gjitha fiset kundër pushtuesit osman, tha se është një koincidencë e mirë fakti se sivjet Papa Françesku ne mesazhin e Tij për Ditën Botërore të Paqes, ka shkruar mesazhin me temën: “Vëllazërimi, themel e udhë për paqen”. Atëherë, në kohën e Shanderbeut u bë bashkim për luftë, sot duhet të bëhet për paqen. Sepse, thotë Papa, është e mundur të jetohet në paqe, nëse



pranojmë zanafillën e përbashkët nga Hyji, Krjuesi i gjithësisë dhe i njerëzimit, dhe në këtë mënyrë mund të shikojmë dhe pranojmë tjetrin si vëlla e motër, pavarësisht nga feja ose nga bindja politike dhe jo si armik ose rival që duhet të shkatërrohet.

Gjithë ceremonia ka qenë zbukuruar me grupin folkloristik, me vjersha dhe muzikë.

MARSHIMI I PAQES



Vijim i fq. 4

drejtësinë që çon në paqe”.

Imzot Massafra, duke shprehur “mirënjohjen e tij të madhe ndaj Bashkësisë së Shën Egjdit që nxiti për të tretin vit radhazi marshimin në Shkodër”, bëri përsëri thirrje të gjithëve për ndërtimin e një botë më të mirë dhe në paqe.

Është e mundur nëse do të kemi si bazë të qenurit vëllezër dhe motra, bijtë e të njejtë Krjuesis; dhe të qenurit bijtë e Hyjit na nxit të shikojmë tjetrin jo si armik ose kundërstar, që do të shkatërrohet, por si vëlla e motër, si thotë Papa

Françesku, megjithatë mund të pëkasim feve ose bindjeve politike të ndryshme.

Atë Nikolla Petani, Meshtar i Kishës Ortodokse, ftoi që të jemi njerëz të paqes në fillim të një viti të shënuar nga 17 konflikte ende të hapura në botë.

Marshimi, që përshkoi qendrën historike të qytetit, përfundoi me mbjelljen e një ulliri në shenjë pajtimi dhe paqeje.

Xhovana Marashi



Drejtues

Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matjia

Faqësia
Luigj Mila

Shtypshkronja
“Gjergj Fishta”
Lezhë

